

UNITED QUARRIES sh.p.k

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 - 21

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar : Menaxhimit dhe Ortakeve të Shoqërisë **United Quarries sh.p.k.**

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **United Quarries sh.p.k.**, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2017, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2017, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare


Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

28 mars 2018


Irena Hoxha (Pak)
Auditues Ligjor
MAZARS
Rr. Emin Duraku, Pall "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phonë : +355 42 27 80 15
www.mazars.al , info@ mazars.al

UNITED QUARRIES sh.p.k.
(Vlerat janë në Lekë)
**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	336,079	320,028
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	517,798	862,727
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	2,062,306	-
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	7,931,331	10,028,101
Inventarë	8	12,481,685	11,672,690
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	9	70,797	72,368
Totali i aktiveve afatshkurtra		23,399,996	22,955,914
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	10	160,471,191	168,972,050
Aktive afatgjatë materiale në proces		4,497,834	4,497,834
Totali i aktiveve afatgjatë		164,969,025	173,469,884
Totali i aktiveve		188,369,021	196,425,798
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	11	-	4,448
Llogari të pagueshme tregtare	12	4,063,655	6,716,041
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	13	89,495,424	63,488,056
Detyrime tatimore	14	447,438	465,665
Të tjera detyrime	15	4,458,266	4,504,153
Totali i detyrimeve afatshkurtra		98,464,783	75,178,363
Detyrime afatgjatë		-	-
Totali i detyrimeve afatgjatë		-	-
Totali i detyrimeve		98,464,783	75,178,363
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		160,000,000	160,000,000
Rezerva të tjera		11,321,024	11,321,024
Rezerva ligjore		3,544,964	3,544,964
Fitime të mbartura		(53,618,553)	(24,017,493)
Fitimi i ushtrimit		(31,343,197)	(29,601,060)
Totali i kapitalit	16	89,904,238	121,247,435
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		188,369,021	196,425,798

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

UNITED QUARRIES sh.p.k.

(Vlerat janë në Lekë)

**Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	17	7,922,880	11,231,960
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	18	813,142	118,760
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	19	1,817,901	2,570,605
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(12,677,278)	(14,786,574)
1) Lënda e parë, materiale dhe shërbime direkte	20	(4,365,923)	(6,287,807)
2) Të tjera shpenzime	21	(8,311,355)	(8,498,767)
Shpenzime të personelit	22	(18,320,741)	(19,695,354)
1) Paga dhe shpërblime		(15,899,501)	(17,048,566)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(2,421,240)	(2,646,788)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	23	(8,251,335)	(8,782,509)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	24	(2,647,774)	(257,964)
Shpenzime financiare	25	8	16
1) Te ardhura/(Shpenzime) interesi dhe shpenzime te ngjashme		8	16
Pjesë e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet			
Fitimi/humbja para tatimit	26	(31,343,197)	(29,601,060)
Fitimi/humbja e vitit		(31,343,197)	(29,601,060)
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(31,343,197)	(29,601,060)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

UNITED QUARRIES sh.p.k.*(Vlerat janë në Lekë)***Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2016	160,000,000	3,544,964	11,321,024	9,203,931	(33,221,424)	150,848,495
Fitimi / Humbja e vitit					(29,601,060)	(29,601,060)
Transferime në fitime të mbartura				(33,221,424)	33,221,424	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	160,000,000	3,544,964	11,321,024	(24,017,493)	(29,601,060)	121,247,435
Fitimi / Humbja e vitit					(31,343,197)	(31,343,197)
Transferime në fitime të mbartura				(29,601,060)	29,601,060	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	160,000,000	3,544,964	11,321,024	(53,618,553)	(31,343,197)	89,904,238

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë aprovuar nga administratori i United Quarries sh.p.k. më ___ Mars 2018 dhe janë firmosur si më poshtë.

Egilda Vyskua Eto

Znj. Egilda Vyskua
Hartues i Pasqyrave Financiare

Z. Charles Michael Bourri

Z. Charles Michael Bourri
Administrator

**UNITED QUARRIES
SH.P.K. ELBASAN**

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Shenime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi përpara tatimit	(31,343,197)	(29,601,060)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8,251,335	8,782,509
Shpenzime zhvleresimi	2,611,188	
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	(45,475)	(2,566,610)
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
Rënie/(rritje) në parapagime e shpenzimet e shtyra	1,571	991
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(169,489)	45,530
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme pale te lidhura	(2,062,306)	4,619,290
Rënie/(rritje) në inventarë	(808,995)	(114,144)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(2,670,614)	3,311,258
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme pale te lidhura	26,007,368	11,657,517
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	(45,887)	(157,225)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(274,501)	(4,021,944)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	295,000	3,921,432
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	295,000	3,921,432
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Pagesa e huave	(4,448)	85
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(4,448)	85
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	16,051	(100,427)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	320,028	420,455
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	336,079	320,028

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "United Quarries" Shpk është regjistruar më 1 korrik 1996 në Regjistrin e Shoqërive me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 38668 datë 27.06.2007.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është prodhimi dhe përpunimi i gurit gëlqeror të fraksionuar, tregëtim i tij etj.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 160,000,000 lekë i cili zotërohet nga:

- Seament Albania Sh.p.k. me 137,600 kuota ose e barabartë me 86 % të kapitalit
- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës me 20,950 kuota ose e barabartë me 13.09% të kapitalit
- Individë të ndryshëm në total 1,450 kuota ose e barabarte me 0.91% të kapitalit

Shoqëria është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave në Elbasan me NIPT: J62904210Q.

Administratori i shoqërisë është Z. Charles Michael Bouri.

Në 31 dhjetor 2017 shoqëria kishte 26 punonjës.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Euro/Lek	132.95	135.23
USD/ Lek	111.10	128.17

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitetet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	5%
Instalime të përgjithshme	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre dhe informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje zyre	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	5%

Toka nuk amortizohet.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerës.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.13. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
<i>Mjete monetare në Lekë</i>	<i>204,672</i>	<i>129,318</i>
Arka	63	63
Banka	204,609	129,255
<i>Mjete Monetare në valutë</i>	<i>131,407</i>	<i>190,710</i>
Arka	-	-
Banka	131,407	190,710
	<u>336,079</u>	<u>320,028</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Klientë për mallra	517,798	862,727
	<u>517,798</u>	<u>862,727</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Fushe Kruja Cement Factory	2,062,306	-
	<u>2,062,306</u>	<u>-</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Tatim fitimi i parapaguar	6,199,052	6,199,052
Të tjera të arkëtueshme nga tatimet	1,933,879	1,559,205
Të arkëtueshme nga dogana	54,832	54,832
Të arkëtueshme nga sigurimet	181,075	128,403
Debitorë të tjerë	2,085,614	2,086,609
TVSH per t' u rimbursuar	88,067	-
Zhvlerësim i llogarive të tjera të arkëtueshme	(2,611,188)	-
	<u>7,931,331</u>	<u>10,028,101</u>
	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Gjendja më 1 janar	-	-
Zhvlerësimi për vitin	2,611,188	-
Gjendja më 31 dhjetor	<u>2,611,188</u>	<u>-</u>

8. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Materiale ndihmëse	10,168,531	10,169,005
Lëndë djegëse	195,169	198,843
Prodhim në proces	2,088,859	1,275,717
Të tjera	29,126	29,125
	<u>12,481,685</u>	<u>11,672,690</u>

9. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime për t'u shpërndarë - Siguracion	70,797	72,368
	<u>70,797</u>	<u>72,368</u>

UNITED QUARRIES sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lekë)

10. Aktive Afatgjata Materiale

	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Kompjutera	Paisje zyre	Aktive në proces	Totali
Kosto								
Gjendja më 1 janar 2016	4,048,400	189,211,415	275,936,624	53,785,247	451,645	550,295	4,497,834	528,481,460
Shtesa			(3,305,700)	(1,020,000)				(4,325,700)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	4,048,400	189,211,415	272,630,924	52,765,247	451,645	550,295	4,497,834	524,155,760
Shtesa	-	-	-	-	-	-	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	(2,262,600)	-	-	-	(2,262,600)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	4,048,400	189,211,415	272,630,924	50,502,647	451,645	550,295	4,497,834	521,893,160
Amortizimi i akumuluar								
Gjendja më 1 janar 2016	-	180,417,453	121,810,636	41,669,384	448,046	528,725	-	344,874,244
Amortizimi i vitit		439,704	7,674,276	663,321	900	4,308		8,782,509
Nxjerrje jashtë përdorimit			(2,028,456)	(942,422)				(2,970,878)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	-	180,857,157	127,456,456	41,390,283	448,946	533,033	-	350,685,875
Amortizimi i vitit	-	417,708	7,261,621	564,444	2,699	4,863		8,251,335
Nxjerrje jashtë përdorimit				(2,013,075)				(2,013,075)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	-	181,274,865	134,718,077	39,941,652	451,645	537,896	-	356,924,135
Vlera neto kontabël								
Gjendja më 31 dhjetor 2016	4,048,400	8,354,258	145,174,468	11,374,964	2,699	17,262	4,497,834	173,469,884
Gjendja më 31 dhjetor 2017	4,048,400	7,936,550	137,912,847	10,560,995	-	12,399	4,497,834	164,969,025

11. Hua afatshkurtra

Huatë afatshkurtra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Overdraft Raiffeisen Bank	-	4,297
Overdraft Credins Bank	-	151
	<u>-</u>	<u>4,448</u>

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Furnitorë	3,876,306	6,404,456
Furnitorë për fatura të pambërritura	187,349	311,585
	<u>4,063,655</u>	<u>6,716,041</u>

13. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Elbasan Cement Factory	88,285,133	62,277,765
Seament Albania	1,210,291	1,210,291
	<u>89,495,424</u>	<u>63,488,056</u>

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	302,926	327,674
Tatimi mbi të ardhurat personale	144,512	97,567
TVSH për t' u paguar	-	40,424
	<u>447,438</u>	<u>465,665</u>

15. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Paga për t'u paguar	4,270,496	4,354,153
Të tjera detyrime ndaj punonjësve	179,600	150,000
Detyrime të tjera	8,170	
	<u>4,458,266</u>	<u>4,504,153</u>

16. Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërise është 160,000,000 LEK dhe zotërohet 100% nga ortakët:

- Seament Albania sh.p.k. me 137,600 kuota (86 % të kapitalit)
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes me 20,950 (13.09 % të kapitalit)
- Individë të ndryshëm në total 1,450 kuota (0.91% të kapitalit)

Rezerva ligjore paraqitet e pa ndryshuar nga viti paraardhës, dhe paraqitet në shumën 3,544,964 Lekë.
Rezerva të tjera paraqitet e pa ndryshuar nga viti paraardhës, dhe paraqitet në shumën 11,321,024 Lekë.
Shuma prej 53,618,553 Lekë përfaqëson humbjen e mbartur nga viti paraardhës.
Rezultati neto i vitit ushtrimor është humbje në shumën (31,343,197) Lekë.

17. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Të ardhura nga shitja e gurit	7,922,880	11,231,960
	<u>7,922,880</u>	<u>11,231,960</u>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Qarkullim i tatueshëm	10,020,067
Zbritet Vlora kontabël e aktiveve të shitura paraqitur neto	(249,525)
Zbritten shpenzimet nga kembimet valutore paraqitur neto	(29,759)
Shuma e qarkullimit e korrektuar	9,740,783
Sipas Kontabilitetit	9,740,783
Diferenca	<u>-</u>

18. Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces

Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	813,142	118,760
	813,142	118,760

19. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Në këtë zë paraqiten të ardhurat e tjera të shfrytëzimit të realizuara nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura të tjera	1,802,187	515
Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata	45,475	2,566,610
Të ardhurat nga këmbimet valutore për marrëdhëniet tregtare	2,811	12,386
Shpenzimet nga këmbimet valutore për marrëdhëniet tregtare	(32,572)	(8,906)
	1,817,901	2,570,605

Rezultati neto nga shitja e AAM-ve paraqitet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017:

<u>Rezultati neto nga shitja e AAM-ve</u>	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga shitja	295,000	3,921,432
Vlera kontabël e aktiveve të shitura	(249,525)	(1,354,822)
	45,475	2,566,610

20. Lëndë të para materiale dhe shërbime direkte

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme dhe shërbimet detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Materiale ndihmëse	83,974	145,185
Lëndë djegëse	3,674	131,936
Shpenzime për energji dhe ujë	2,656,065	3,413,295
Shpenzime transporti	1,436,022	2,035,793
Taksa minerare	186,188	561,598
	4,365,923	6,287,807

21. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shërbimi rojes private	5,349,630	4,145,250
Taksa dhe tarifa vendore	1,551,066	2,441,362
Mirëmbajtje dhe riparime	419,752	16,000
Sigurime	374,766	290,456
Konsulenca dhe shërbime nga të tretë	315,244	1,400,000
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	204,140	60,470
Komisione bankare	64,947	64,519
Të tjera	31,810	80,710
	<u>8,311,355</u>	<u>8,498,767</u>

22. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Pagat dhe shpërblimet e personelit	15,899,501	17,048,566
Sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	2,421,240	2,646,788
	<u>18,320,741</u>	<u>19,695,354</u>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2017 është 26 (31 dhjetor 2016: 29).

23. Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	8,251,335	8,782,509
	<u>8,251,335</u>	<u>8,782,509</u>

24. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Gjoha dhe dëmshpërblime	36,586	257,964
Zhvlerësimi i llogarive të tjera të arkëtueshme	2,611,188	-
	<u>2,647,774</u>	<u>257,964</u>

UNITED QUARRIES sh.p.k.
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
 (Vlerat janë në Lekë)

25. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat dhe detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga interesat	8	16
	<u>8</u>	<u>16</u>

26. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
<i>Fitimi para tatimit</i>	(31,343,197)	(29,601,060)
Shpenzime të panjohura	2,881,774	289,464
Shpenzime udhëtimi		
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	36,586	257,964
Shpenzime zhvlerësimi (provizione)	2,611,188	
Shpenzime të tjera	234,000	31,500
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	(28,461,423)	(29,311,596)
Humbje fiskale e mbartur	(103,156,739)	(91,596,115)
Humbja fiskale e vitit	(131,618,162)	(120,907,711)
<i>Tatim fitimi @15%</i>	-	-
Fitimi i vitit	<u>(31,343,197)</u>	<u>(29,601,060)</u>

27. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat dhe transaksionet me palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Fushe Kruja Cement Factory	2,062,306	-	-	-
Elbasan Cement Factory	-	88,285,133	-	62,277,765
Seament Albania	-	1,210,291	-	1,210,291
	<u>2,062,306</u>	<u>89,495,424</u>	<u>-</u>	<u>63,488,056</u>

27. Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)

Politika e vendosjes së çmimeve për transaksionet me palët e lidhura janë kryer me kushte tregtare dhe me çmime të përafërta me ato të tregut.

	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Fushe Kruja Cement Factory	1,802,090	83,502	-	-
Elbasan Cement Factory	7,922,977	-	15,089,188	327,008
Seament Albania	-	-	-	-
	9,725,067	83,502	15,089,188	327,008

28. Angazhime dhe pasiguri*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2017 shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

29. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.